

Bio

## **Lirika Pula Kasapolli**, pianiste

E lindur në Gjakovë, ku mori edhe mësimet e para në piano për ti vazhduar ato në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup. Studimin në piano e zhvilloi me profesorët Selami Ballata, Agron Shujaku, Merita Rexha Tërshana dhe në vitin 2011 fitoi titullin Master në Piano Interpretim në Shkup nën drejtimin e Prof. Todor Svetiev.

Gjatë këtyre viteve ajo ka marrë pjesë rregullisht në masterkurset e mbajtura nga pianistë të ndryshëm, si dëgjuese dhe pjesëmarrëse aktive. Në vitin 2013 ajo mori pjesë në Accademia Musicale Chigiana në Siena të Italisë drejtuar nga pianistja ruse Lilya Zilberstein.

Repertoari i saj përfshinë vepra të epokave të ndryshme të muzikës serioze, por krahas tyre ajo është e hapur të mësojë, të njohë dhe të performojë muzikë kontemporane e posaqërisht vepra nga kompozitorë kosovarë.

Ajo është pianiste aktive në skenën e muzikës në Prishtinë ku ka bashkëpunuar me një numër të muzikantëve shqiptar dhe ndërkombëtar, ndër të cilët Lule Ballata (Kosovë) flaut, Sanije Matoshi (Kosovë) mezzosoprano, Blerta Zhegu (Shqipëri) soprano, Rasmus Krøyer (Danimarkë) klarinet, Bülent Evcil (Turqi) flaut, Merita Rexha Tërshana (Shqipëri) piano, Sabine Weyer (Luxemburg) piano, Besa Llugiqi (Kosovë) soprano, Visar Kuqi (Kosovë) violinë, Adelina Paloja (Kosovë) soprano etj. Ajo është ftuar të performojë në festivalet më prestigjioze në Kosovë dhe rajon duke përfshirë DAMfest, ReMusica festival, Chopin Fest (Kosovë) dhe Chopinfest e Pianodrom (Shqipëri), Vivo Festival (Mal te Zi), Maqedoninë e Veriut, Slloveni, Beograd e Luxemburg. Ajo luajti dy herë si soliste me Orkestrën Kamertale të Filharmonisë së Kosovës veprën shumë të famshme nga Saint-Saens “Karnavali i Kafshëve” nën drejtimin e dirigjentes franceze Nathalie Marin dhe dirigjentit kosovar Edon Ramadani.

Gjithashtu, ajo është anëtare e ansamblit të muzikës së dhomës Trio “Entr’acte” me të cilin është paraqitur në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri e Mal të Zi.

Vitet e fundit ajo është ftuar rregullisht si pianiste bashkëpunëtoresh nga Kori dhe Orkestra e Filharmonike e Kosovës si dhe ESMA (European Summer Music Academy).

Që nga viti 2006–2018 ajo punoi si pedagoge e pianos në shkollën e muzikës ‘Prenk Jakova’ në Prishtinë. Ndërsa si pianiste korrepetitore ajo ka përvojë shumë vjeçare me katedrën e kantos dhe katedrën e harqeve në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ku punon në formë të rregullt.